

2012/04

# Efiçienca e energjisë në Kosovë

Analizë e kornizës ligjore dhe zbatueshmërisë së saj



Hulumtimi për këtë studim është realizuar në kuadër të programit të Qeverisjes Demokratike që përkrahet nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe programit për Zhvillim të Qëndrueshëm që përkrahet nga Fondi i Vëllezërve Rockefeller.

Autorë: **Dardan Abazi, Darsei Canhasi, Burim Ejupi dhe Rinora Gojani**

Redaktor: **Krenar Gashi**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

62-531.9:34(496.51) 621.3.095:34(496.51)

Efiçienca e energjisë në Kosovë : analizë e kornizës ligjore dhe zbatueshmërisë së saj 2012/04 / Dardan Abazi...[et al.].

Prishtinë : Instituti për Politika Zhvillimore, 2012. - 24 f. ; 30 cm.

**ISBN 978-9951-627-03-0**



**Bashkëpunimi Rajonal**  
Regional Cooperation



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development



**Qeverisja Demokratike**  
Democratic Governance

## PËRMBAJTJA

1. HYRJE .....	4
2. INFORMATA TË PËRGJITHSHME .....	7
3. POLITIKAT PËR RRITJEN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË .....	9
3.1. Ligji i Kosovës për Efiçencën e Energjisë .....	11
3.1.1 Zbatimi i Ligjit për Efiçencën e Energjisë.....	13
4. ANALIZË KRAHASUESE E LIGJIT PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË SË KOSOVËS ME SHTETET E RAJONIT .....	14
5. PËRFUNDIMET .....	20
6. REKOMANDIMET .....	23
7. ANEKSET .....	25

## SHKURTESAT

<b>AKEE</b>	Agjencia e Kosovës për Eficiencën e Energjisë
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>INDEP</b>	Instituti për Politika Zhvillimore
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KOSTT</b>	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut
<b>KTOE</b>	Kiloton naftë ekuivalente
<b>MTOE</b>	Megaton naftë ekuivalente
<b>MZHE</b>	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
<b>TKE</b>	Traktati i Komunitetit të Energjisë
<b>TOE</b>	Ton naftë ekuivalente
<b>ZRRE</b>	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

## 1. HYRJE

Energjia dhe burimet e mjaftueshme të energjisë përbëjnë një nga sfidat më të mëdha të civilizimit njerëzor, e sidomos të vendeve në zhvillim. Mungesa e burimeve të mjaftueshme të energjisë dhe kapitalit për t'i shfrytëzuar ato burime, ka ngritur nevojën për shfrytëzim sa më eficient të sasisë ekzistuese të energjisë. Këto shqetësime i shtohen problemeve të ngritjes së sasisë të dioksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>) të emtuar në atmosferë, një problem i identifikuar global. Duke i pasur parasysh këto sfida, eficientia e energjisë shihet si një metodë e mirë për të reduktuar dhe për të vënë nën kontroll nxitimin enorm në shfrytëzimin e energjisë.

Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare përmes marrëveshjeve të ndryshme, kanë bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të uljes së nivelit të konsumit global të energjisë. Protokollin e Kyotos në vitin 1998 për Konventën Kornizë të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, përcakton që çdo shtet duhet të marrë masa për të rritur eficientinë e energjisë në nivelin kombëtar.<sup>1</sup> Si rezultat, në drejtim të përmbushjes së këtyre objektivave për eficientinë e energjisë kanë filluar të merren masa në shumë vende të botës.

Eficientia e energjisë është një fushë e gjerë dhe një objektiv jo i lehtë për t'u arritur, që nënkupton uljen e konsumit të energjisë në një territor të caktuar. Që nga baza ligjore, gjendja teknike e rrjetit e deri tek sjellja e konsumatorëve, eficientia është rezultat i shumë faktorëve. Ajo nënkupton të gjitha veprimet dhe aktivitetet që rezultojnë me uljen e sasisë së energjisë të nevojshme për ofrimin e një shërbimi (nxehja, ndriçimi, etj) ose mundësimit i një aktiviteti.<sup>2</sup> Treguesi i nivelit të eficientisë së energjisë konsiderohet sasia e konsumuar e energjisë në vit në krahasim me nivelin e bruto produktit vjetor për kokë banori (GDP).<sup>3</sup> Një krahasim i tillë mundëson vlerësimin e sasisë së energjisë së harxhuar për totalin e prodhimeve në vend, duke paraqitur gjendjen e eficientisë në një vend.

Politika të shumta publike hartohen me qëllim të rritjes së nivelit të kursimit të energjisë. Investimet në aspektin teknik, masat stimuluese, informimi dhe vetëdijesimi në këtë fushë janë pikat kryesore në rritjen e eficientisë. Investimet teknike në funksion të prodhimit dhe distribucionit eficient të energjisë janë të një rëndësie të madhe në një kohë kur shumë shtete humbasin sasi të mëdha të energjisë gjatë procesit të shpërndarjes.

---

<sup>1</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara. Protokollin e Kyotos, Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin Klimatik. (1998)

<sup>2</sup> Këshilli Botëror i Energjisë. Eficientia e Energjisë: Një Plan për Sukses. (2010). (Anglisht)

<sup>3</sup> Ibid.

Investimet në eficiencën e energjisë në Kosovë, sikurse edhe gjithë investimet tjera në përgjithësi, kanë munguar për gati dy dekada gjatë kohës së represionit. Shkatërrimet që i janë bërë Kosovës gjatë luftës së fundit bënë që shoqëria kosovare t'i rreket një rindërtimi të shpejtë dhe të fuqishëm. Për shkak të zhvillimeve gjeopolitike, luftës dhe probleme të shumta ekonomike, Kosova besohet të jetë e fundit nga vendet e rajonit sa i përket eficiencës së energjisë.

Banka Botërore disponon tabelën me të dhënat mbi humbjet e energjisë në rrjetin e transmisionit dhe distribucionit për shtete të ndryshme. Në ato tabela shihet se edhe pse trendet janë në rënie, prapë se prapë humbjet gjatë transmisionit dhe distribucionit mbesin të mëdha. Humbjet teknike mbesin një problem serioz edhe për Kosovën.

Shumica absolute e energjisë në Kosovë shpenzohet për nevoja rezidenciale.<sup>4</sup> Shumica absolute e shtëpive në Kosovë, përfshirë këtu ndërtimet e vjetra por edhe ato të reja, nuk janë eficiente. Për më shumë, një shumicë e madhe e shtëpive dhe banesave në Kosovë përdorin energjinë elektrike për ngrohje, gjë që e bën eficiencën e energjisë të jetë në një nivel alarmant të ulët. Autoritetet e Kosovës kanë filluar planifikimin dhe hartimin e politikave publike sa i përket eficiencës në mënyrë të mbrapshtë, duke u nisur më shumë nga kërkesat që bëhen nga Bashkimi Evropian, sesa nga baza themelore e nevojës për eficiencë.

Baza ligjore me të cilën Kosova është përpjekur të rregullojë fushën e eficiencës së energjisë ka filluar me Ligjin për Energji Nr. 2004/8 në vitin 2004. Kjo kornizë ligjore ka vazhduar me Ligjin për Energjinë Elektrike Nr. 03/L201, Ligji për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185 dhe Ligji për Energjinë Nr. 03/L-184 që e shfuqizon dhe zëvendëson ligjin e vitit 2004. Ligji më i rëndësishëm, Ligji për Eficiencën e Energjisë, tenton të definojë në mënyrë më specifike rolin dhe kompetencat e institucioneve si dhe është qenësor për krijimin e bazës institucionale për eficiencën e energjisë. Sidoqoftë, ligji për eficiencën e energjisë plotësohet edhe nga planet, strategjitë, udhëzimet dhe rregulloret e ndryshme që burojnë nga ministria e linjës dhe institucionet tjera përgjegjëse.

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka monitoruar zbatimin e Ligjit për Eficiencë të Energjisë. Nga analizimi i dokumenteve dhe të dhënave rezulton se të gjitha dokumentet zyrtare mundohen të përmbushin kërkesat e dala nga Direktiva e Bashkimit Europian (BE) 2006/032 mbi Eficiencën e Energjisë. Zbatimi i tyre është një gjë krejt tjetër, ku për shkak të mungesës së ciklit për krijim të politikave, ligji nuk është duke u zbatuar plotësisht. Sidoqoftë, sfida të reja në fushën legjislativë janë duke u shfaqur meqë Bashkimi Evropian është në fazën finale të miratimit

---

<sup>4</sup> Ekspertët vlerësojnë se mbi 80% të energjisë shpenzohet për nevoja amvisërie

të Direktivës 2011/0172 e cila ka paraparë objektiva më të larta në fushën e efijencës së energjisë.

Ky publikim analizon tërthorazi dhe shkarazi elementet e politikës publike sa i përket efijencës së energjisë. Qëllimi i publikimit është të vë në dukje problemet e këtyre elementeve duke hapur rrugë për studime tjera, më të thella, sa i përket përmirësimit të përgjithshëm të politikës publike në këtë sferë. Publikimi pasqyron gjendjen e tanishme kryesisht në aspektin ligjor por edhe atë praktik të efijencës, me qëllim që të ndihmojë institucionet relevante në ndryshimin e politikave dhe marrjen e masave shtesë në drejtim të arritjes së efijencës së energjisë. Fokus i veçantë i punimit është aspekti legjislativ, ku analizohen Ligji për Efijencën e Energjisë dhe Plan i Parë Afat-Mesëm i Veprimit i Kosovës për Efijencën e Energjisë 2010-2012.

Gjatë përgatitjes së këtij punimi, INDEP ka përdorur një metodologji cilësore. Pikë kyçe e punimit është analiza e Ligjit për Efijencën e Energjisë së Kosovës, respektivisht përmbajta e ligjit, niveli i zbatueshmërisë dhe harmonia me Direktivave të BE-së dhe ligjet e vendeve të rajonit. Udhëzimet administrative, aktet nënligjore, planet e veprimit dhe strategjitë shërbyen për të një studim më të thellë të Ligjit për Efijencë dhe për të kuptuar fushëveprimin e tij. Për nivelin e përmbushjes së predispozitave ligjore të parapara me Ligjin për Efijencën e Energjisë, “Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Efijencën e Energjisë” i përgatitur nga INDEP ishte bazë për këtë punim. Në anën tjetër, pjesa e analizës krahasuese të ligjit të Kosovës me ligjet e shteteve të rajonit ofroj mundësi për të i identifikuar një mori gjetjesh të dobishme që kontribuuan edhe në përfundimet e punimit. Përveç ligjeve të shteteve të rajonit, Direktivat e Bashkimit Evropian për Efijencë dhe Energji është përdorur si referencë e rëndësishme gjate analizës. Në fund, për t’i ndihmuar shqyrtimit më të thellë të shkaqeve dhe pasojave të gjetjeve të këtij studimi, INDEP ka realizuar intervista me zyrtarë përgjegjës të institucioneve të Agjencisë për Efijencën së Energjisë, Departamentit të Energjisë pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Zyrës për Rregullatorin e Energjisë.

## 2. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Në Kosovë, energjia elektrike prodhohet nga djegia e thëngjillit. Më shumë se 97% e energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë vjen nga dy termocentralet ekzistuese, Kosova A dhe Kosova B.<sup>5</sup> Përveç problemeve që këto dy termocentralet kanë pasur në prodhim, me daljet e shpeshta nga funksioni, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është përballur edhe me probleme në faturimin e energjisë, ku në vitin 2011 74.35% e energjisë në shitje është faturuar.<sup>6</sup> Përveç kësaj, probleme enorme janë humbjet e mëdha të energjisë, ku gjatë vitit 2011 humbjet e regjistruara përbënin 38.15% të konsumit total.<sup>7</sup> Kështu, totali i humbjeve në sistem ndahen në 16.78 % humbje teknike dhe 21.37% humbjet komerciale.<sup>8</sup> Humbje të tilla të mëdha të energjisë janë duke ndodhur në kohën kur kërkesa për konsum të energjisë ka shënuar rritje.

Në vitin 2009 konsumi i përgjithshëm bruto ishte 5,275,108 MWh, ndërkohë që në vitin 2011 kjo shifër është rritur në 5,584,370 MWh, ose afër 6%.<sup>9</sup> Në anën tjetër edhe niveli i Bruto Produktit për kokë banori (GDP për Capita) është rritur dhe kësaj i ka kontribuar edhe numri më i vogël i raportuar i banorëve sesa që ishte i kalkuluar më parë. Kështu, Bruto Produkti për kokë banori për vitin 2011 është 2,368 euro.<sup>10</sup> Prandaj, rritja e vazhdueshme e konsumit dhe humbjet e mëdha teknike e komerciale në rrjetin e transmisionit dhe të shpërndarjes kanë shtuar nevojën për masa adekuate në drejtim të arritjes së objektivave për eficiencën e energjisë.

Plani i Parë Afatmesëm i Veprimit i Kosovës për Eficiencën e Energjisë 2010-2012 parasheh që të arrihet 9% kursim deri më 2018<sup>11</sup>, përderisa Direktiva Evropiane 2006/32/EC parashihte që ky objektiv të arrihet jo më vonë se deri më 2016<sup>12</sup>. Objektivi prej 9% është llogaritur duke zbritur për 9% vlerën totale të kërkesës së parashikuar të energjisë për periudhën 2009-2018. Një parashikim i tillë i energjisë është bërë duke marrë parasysh skenarin mesatar të rritjes së Bruto Produktit (GDP) prej 3.1%.

Niveli i parashikuar i kërkesës së energjisë në Planin e Veprimit nuk përputhet me atë të parashikuar me Strategjinë për Energji të vitit 2009-2018. Deri sa Strategjia për Energji parasheh që deri në vitin 2018 do të ketë një rritje të kërkesës për energji prej mbi 65% në krahasim me vitin 2005, Plani i Veprimit parasheh që kjo rritje në krahasim me vitin 2005 të jetë vetëm 48%.

<sup>5</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Raporti vjetor 2011. Prishtinë (2012). faqe 29.

<sup>6</sup> Ibid. faqe 36.

<sup>7</sup> Ibid. faqe 34.

<sup>8</sup> Ibid.

<sup>9</sup> Ibid. faqe 24.

<sup>10</sup> World Bank (2011), Kosovo Partnership Program Snapshot.

<sup>11</sup> Plani i parë afat mesëm i Veprimit i Eficiencës së Energjisë për Kosovën (2010-2012), faqe 19.

<sup>12</sup> Bashkimi Europian. Direktiva numër 32 e vitit 2006, Gazeta Zyrtare e 27 prill 2006, L114, faqe 64.



Shprehur në ktoe (kiloton naftë ekuivalente), Plani i Veprimit parasheh që në vitin 2018 kërkesa të jetë 1610 ktoe<sup>13</sup>, kurse Strategjia e Energjisë parasheh nivel prej 1920 ktoe<sup>14</sup> të kërkesës për energji në vitin 2018.

Duke kalkular me këto shifra që nuk përputhen me Planin e Kosovës për Energji, Plani i Veprimit ka nxjerrë shifrën mesatare të konsumit duke marrë për bazë vlerat e konsumit për pesë vitet para aplikimit të Direktivës (periudha 2003 – 2007), ku ka nxjerrë shifrën prej 1021.08 ktoe prej nga janë zbritur 9% si objektivë për eficiencë, përkatësisht 91.89 ktoe.<sup>15</sup> Për më tepër, vërejmë se për të nxjerrë konsumin mesatar, hartuesit e Planit të Veprimit kanë marrë periudhën e saktë prej pesë vitesh para zbatimit të Direktivës 2006/32, ashtu siç kërkohet në direktivë. Në anën tjetër, objektivi prej 9% është paraparë deri më 2018 dhe jo në nëntë vitet e zbatimit të Direktivës 2006/32, ashtu siç kërkonte direktiva.<sup>16</sup> Kjo përbën një problem madhor pasi që Plani i Veprimit e ka përdorur një periudhë më të vjetër (ku konsumi ishte më i vogël) për të nxjerrë mesataren dhe kalkular nevojat për eficiencë, që rrjedhimisht e bën objektivin më të ulët. Si rezultat, Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencën e Energjisë e ka objektivin për afër 11% më të ulët se sa Plani i Kosovës për Energji.

	<b>Plani i Veprimit</b>	<b>Plani për Energji</b>
<b>Niveli mesatar i konsumit të energjisë</b>	1021.08 ktoe	1144 ktoe
<b>Niveli prej 9% për kursim deri më 2018</b>	91.89 ktoe	102.96 ktoe
<b>Diferenca %</b>	<b>-10,75%</b>	

Për më tepër, propozimi në Direktivën e re të Bashkimit Evropian për Eficiencën e Energjisë 2011/0172<sup>17</sup> thotë që deri më 2020 objektivi është 17%. Edhe nëse respektohet objektivi prej 9% deri më 2018 i Planit të Veprimit, Kosova prapë do të jetë prapa direktivës në fuqi 2006/32/EC që obligon kursim prej 9% deri më 2016. Caku i paraparë me Planin e Veprimit nuk është i vlefshëm pasi që nuk është harmoni me direktivën në aspektin e kuantitetit objektivës dhe

<sup>13</sup> Plani i parë afat mesëm i Veprimit i Eficiencës së Energjisë për Kosovën (2010-2012), faqe 19.

<sup>14</sup> Republika e Kosovës, Ministria e Energjisë dhe Minierave (2009), Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2009 – 2018, faqe 54.

<sup>15</sup> Plani i parë afat mesëm i Veprimit i Eficiencës së Energjisë për Kosovën (2010-2012), faqe 19-20.

<sup>16</sup> Direktiva 2006/32/EC, Aneksi 1, 1c.

<sup>17</sup> Direktiva e re Evropiane 2011/0172 bën shfuqizimin e Direktivës Evropiane 2006/32/EC.

kohës.<sup>18</sup> Për më tepër, nga analiza në vazhdim, shihet që në raport me vendet e rajonit, Kosova ka objektivat më të ulëta për kursimin e energjisë.

Objektivi i paraparë me Planin e Veprimit ka filluar të implementohet, megjithëse niveli i inspektimit të zbatueshmërisë së tij nuk ka qenë i kënaqshëm. Deri në maj 2012, Kosova ka shënuar 2.2% kursim të energjisë, që është një shifër e kënaqshme kundrejt objektivit të paraparë me Planin e Veprimit dhe me Planin afatmesëm 2010-2012 ku objektivi është 3%.<sup>19</sup> Megjithatë, kjo mbetet nën hije kur konsiderohet objektivi i ulët i paraparë me Planin e Veprimit 2010-2018 dhe në krahasim me kërkesat e reja të Bashkimit Evropian.

Komunat kanë përgjegjësinë e implementimit të një pjese të konsiderueshme të objektivave për efikasitet. Kjo pasi Ligji për Efikasitet parasheh që secila komunë të hartojë planin e vet komunal dhe të i raportojë periodikisht AKEE-së në lidhje me implementimin e këtyre planeve. Këto masa do të mund të shtrinin implementimin e objektivave të Planit të Veprimit edhe nëpër komuna, çka do të i bënte objektivat për efikasitet më të arritshëm.

Përkundër kësaj, qeverisja lokale ka ngecur në implementimin e masave për efikasitetin e energjisë. Ligji për Efikasitetin ka dështuar të krijojë bazën e nevojshme institucionale të nivelit komunal me të cilin do të implementoheshin plane të veçanta komunale për efikasitetin e energjisë.<sup>20</sup> Një ngecje e tillë ka shkaktuar mungesën e theksuar të përparimit në nivelin komunal në fushën e efikasitetit të energjisë.

### **3. POLITIKAT PËR RITJEN E EFIÇIENCËS SË ENERGISË**

Disa nga politikat e hartuara për rritjen e efikasitetit në Kosovë janë fuqizimi i Udhëzimit Administrativ për Etiketimin e produkteve Energjetike, futja e akcizës për poqët elektrike jo eficientë, obligimi i aplikimit të masave efikasitetit të energjisë gjatë marrjes së lejes së përdorimit të objekteve ndërtimore, shtrenjtimi i rrymës prej 8.9% dhe aplikimi i bllok tarifave.

Etiketimi i pajisjeve që shfrytëzojnë energji, siç do të shpjegohet më vonë, është një praktikë që përdoret në shumë vende të tjera. Në korrik të vitit 2012, në Kosovë hyri në fuqi Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2012 për Etiketimin e Pajisjeve që Shfrytëzojnë Energji.<sup>21</sup> Ky vendim iu mundëson konsumatorëve që të jenë të informuar për shpenzimin e energjisë për pajisjet e

<sup>18</sup> Intervistë e INDEP me Vlasis Oikonomou, Ekspert (Politikat e Energjisë dhe Klimës) në Joint Implementation Network. Prishtinë, Kosovë, Tetor 2012.

<sup>19</sup> Intervistë e INDEP me Bedri Dragushën, Kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Efikasitet të Energjisë. Prishtinë, Kosovë, Korrik 2012.

<sup>20</sup> Raport për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Efikasitetin e Energjisë. Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP). Prishtinë (2012), faqe 4.

<sup>21</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës. Udhëzim Administrativ Nr. 09/2012 për Etiketimin e Pajisjeve që Shfrytëzojnë Energji.

ndryshme, që si rezultat ofron kushte për përdorim më të kujdesshëm të tyre dhe njëherazi iu mundëson kontrollimin e nivelit të konsumit të energjisë.

Akciza në poqët elektrike jo eficient është një masë tjetër për të rritur eficiencën e energjisë tek konsumatorët. Me vendimin Nr. 01/75 të datës 23 maj 2012 të Qeverisë së Kosovës, u aprovua kërkesa e Ministrisë së Financave për shtimin e listës të Aneksit A në Ligjin Nr. 03/L-220 për Normën e Tatimit të Akcizës në Kosovë në qeset plastike, gomat e përdorura dhe poqët elektrikë jo-eficient.<sup>22</sup> Prej hyrjes në fuqi, çdo poq elektrik jo eficient do të ketë akcizë prej 30 Euro cent, që si rezultat do ta ulë kërkesën në treg për to dhe të rrisë kërkesën për poqët eficient.

Ligji i Republikës së Kosovës për Ndërtim, i miratuar më 31 maj 2012, përcakton masa të aplikimit të eficiencës së energjisë në objektet ndërtimore. Ligji parasheh që masat për eficiencën janë njëra nga qëllimet e Kodit Unik të Ndërtimit të Republikës së Kosovës.<sup>23</sup> Dihet rëndësia e objekteve ndërtimore që kanë eficiencën për bazë dhe kjo tani kërkohet me Ligjin për Ndërtim, ku çdo përdorues i objekteve ndërtimore obligohet që të pajiset me certifikatën e përdorimit, kusht i të cilës janë edhe masat e kursimeve dhe eficiencës së energjisë.<sup>24</sup> Prandaj, Ligji për Ndërtim është një hap përparues, ani pse do të ishte me e favorshme nëse masa të tilla do të ishin të futura direkt në Ligjin për Eficiencën e Energjisë.

Në qershor të vitit 2012, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka aprovuar tarifat e reja të energjisë elektrike, të cilat shënojnë një rritje të çmimit me vlerë prej 8.9%. Ky vendim erdhi si rezultat i kërkesës së Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) që tarifat të rriten për 23%, kërkesë të cilën ZRRE e shqyrtoi dhe morri vendimin që norma e shtrenjtimit të jetë 8.9%.<sup>25</sup> Në njoftimin për media të ZRRE-së nuk përmendet eficientia e energjisë si njëra nga arsyet për rritjen e tarifave. Për më tepër, për ZRRE-në është e rëndësishme që tarifat të mbulojnë koston e prodhimit dhe shërbimit dhe rritja çmimit nuk bëhet për t'i kontribuar eficiencës së energjisë.<sup>26</sup> Sidoqoftë, pritet që ky shtrenjtim të ulë konsumin e energjisë dhe si rezultat të kontribuojë në eficientë.

Një politikë që e rrit eficiencën, edhe përkundër faktit që nuk është vendosur si qëllim i kësaj politike, janë bllok tarifat që filluan në vitin 2006. E menduar si politikë sociale për t'i ndihmuar të varfrit, ajo teorikisht duhet të kenë ndikim edhe në kursimin e energjisë edhe pse nuk ka matje

---

<sup>22</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendim Nr. 07/75, 23 maj 2012.

<sup>23</sup> Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim. Kosovë. Neni 6.

<sup>24</sup> Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim. Kosovë. Neni 27.

<sup>25</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji. Njoftim për Media: Aprovimi i Tarifave të Reja të Energjisë Elektrike. 20 qershor 2012.

<sup>26</sup> Intervistë e INDEP me Ardian Berishën, Kryesues i Departamentit për Tarifa dhe Çmime në ZRRE, Prishtinë, Shtator 2012.

që dëshmojnë një gjë të tillë.<sup>27</sup> Efekti që rritja e tarifave të energjisë elektrike dhe aplikimi i bllok tarifave kanë në efikasitet është i pamundshëm për t'u vlerësuar për shkak të mungesës së matjeve të këtij efekti, ku njëri nga më të thjeshtit është matja e elasticitetit ekonomik.<sup>28</sup> Matjet e elasticitetit tregojnë ndikimin e çdo lëvizje në çmimin e energjisë elektrike kundrejt kërkesës në treg.

### **3.1. LIGJI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË**

Ligji Nr. 04/L-016 për Efikasitetin e Energjisë është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 23 qershor 2011. Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë kuadrin e nevojshëm ligjor dhe institucional për rregullimin e fushës së efikasitetit të energjisë. Fushëveprimi i ligjit rregullon çështjen e efikasitetit të energjisë, përgatitjen dhe promovimin e planeve të efikasitetit të energjisë dhe raportimit, përcaktimin e roleve, detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve si dhe adresimin e detyrimeve që burojnë nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.<sup>29</sup> Përveç këtyre, me ligjin për efikasitet të energjisë përcaktohen detyrat e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe Agjencisë Kosovare për Efikasitetin e Energjisë (AKEE), themelimi dhe funksionimi i Komisionit për Certifikimin e Auditorëve dhe Menaxherëve të Energjisë, menaxhimi i energjisë në sektorin publik, financimi i masave për efikasitetin e energjisë, auditimi i energjisë dhe zbatimi i Direktivave të Bashkimit Evropian (BE) të së njëjtës fushë.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Agjencia Kosovare për Efikasitetin e Energjisë dhe Zyrat Komunale për Efikasitetin e Energjisë janë institucionet kryesore të ngarkuara me implementimin e Ligjit për Efikasitetin, Planit të Veprimit dhe akteve të tjera nënligjore. Pasi që ligji është miratuar në qershor të vitit 2011, disa nga punët e bëra nga MZHE më parë lidhur me efikasitetin, si Plani i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë 2010-2018, i janë trashëguar AKEE-së.<sup>30</sup> Kjo ka bërë që AKEE të gjejë të gatshëm Planin e Veprimit 2010-2018 si dhe Planin afatmesëm 2010-2012 në kohën kur janë formuar.

Ligji i Kosovës për Efikasitet të Energjisë është një dokument 7 faqësh i cili përmban gjithsej 16 nene. Shumica e shteteve të analizuara në këtë punim kanë ligje të cilat janë më të detajuara dhe që në përmbajtje janë më cilësore e sasiore. Në anën tjetër, Ligji i Kosovës për Efikasitetin e

---

<sup>27</sup> Intervistë e INDEP me Ardian Berishën, Kryesues i Departamentit për Tarifa dhe Çmime në ZRRE, Prishtinë, Shtator 2012.

<sup>28</sup> Ibid.

<sup>29</sup> Kosova e ka nënshkruar Traktatin e Komunitetit të Energjisë të Bashkimit Evropian më 31 maj 2005.

<sup>30</sup> Përveç Ligjit për Efikasitetin e Energjisë, rregulloret tjera që merren me efikasitet janë: Ligji për Energji (Ligji Nr. 03/L-184), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L-201), Plani i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë 2010-2018, Rregullorja Nr. 01/2012 për themelimin e Komisionit për Certifikimin e Auditorëve dhe Menaxherëve të Energjisë, Rregullorja Nr. 08/2011 për Organizimin e Brendshëm të AKEE-së, Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2012 për Auditimin e Energjisë, Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2008 për promovimin efiçent të energjisë, Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2009-2018 dhe Direktiva Evropiane për Efikasitet të Energjisë 2006/32/EC

Energjisë në disa raste i referohet Planit të Veprimit për Eficiencë si një akt nënligjor. Në termin e politik bërjes, aktet nënligjore, planet dhe strategjitë e ndryshme janë dokumente që mund të ndryshohen në nivelin ekzekutiv pa pasur nevojë miratimin nga Kuvendi, gjë që në rastin e Kosovës është rregulluar ndryshe pasi rregullimi i fushës së eficiencës ka mbetur në nivel të akteve nënligjore që mund të ndryshohen pa pëlqimin e organit legjislativ. Shumica e vendeve të krahasuara në këtë studim i kanë pasur me ligj të rregulluara aspekte të caktuara të eficiencës së energjisë. Aktet nënligjore kanë shërbyer thjeshtë për specifikimin e aspekteve kohore dhe të kostove të veprimeve që në parim do të duhej të specifikoheshin në ligj. Megjithatë, kuadri ligjor vijon të përmirësohet krahas kërkesave të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe direktivave përkatëse.<sup>31</sup> Sidoqoftë, mungesa e provizioneve të detajuara në Ligjin për Eficiencën e Energjisë vazhdon të mbetet një problem shqetësues sa i përket përkushtimit të institucioneve shtetërore rreth çështjes së eficiencës.

Rregulloret e Kosovës për eficiencë, përfshirë ligjin dhe planin e veprimit, janë të mangëta në disa aspekte duke krahasuar me Direktivën e Bashkimit Evropian 2006/32 me të cilën këto dokumente do të duhej të ishin në harmoni. Për ilustrim, në Kosovë nuk parashihet auditimi i sistemeve të ngrohjes dhe klimatizimit, gjë që është komponentë e Direktivës së BE-së, 2006/32 por që do të jetë edhe e Direktivës së re 2011/0172. Nga pjesa e analizës në vijim ku bëhet krahasimi i ligjit të Kosovës me ato të rajonit, shihet qartë se shtetet e rajonit përdorin masa stimuluese për motivimin e përdoruesve të energjisë për të kursyer energjinë elektrike, aspekt në të cilin Kosova stagnon. Gjithashtu, mangësia e radhës në Kosovë është fakti se nuk parashihen gjopa për individët dhe kompanitë që nuk i respektojnë Ligjin mbi Eficiencën apo aktet e tjera nënligjore që burojnë nga ky ligj. Në fund, Ligji për Eficiencë të Energjisë nuk përmban detyrime për prodhuesit dhe importuesit e produkteve që konsumojnë energji ose detyrime për objektet që shpenzojnë energji dhe nuk ka detyrime shtesë për kompanitë e mëdha me konsum të lartë energjetik. Sidoqoftë, Plani i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2010-2018 përmban detyrime për prodhuesit dhe importuesit e produkteve që konsumojnë energji siç është instruksioni administrativ për etiketimin e pajisjeve shtëpiake. Përveç kësaj, në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L – 110 shohim obligime për masa të eficiencës që kërkohen gjatë certifikimit të përdoruesve të objekteve ndërtimore.

---

<sup>31</sup> Intervistë e INDEP me Luan Morinën, Drejtor i Departamentit të Energjisë dhe Minierave në MZHE. Prishtinë, Kosovë, Shtator 2012.

### 3.1.1 Zbatimi i Ligjit për Eficiencën e Energjisë

INDEP ka bërë monitorimin e detajuar të Ligjit për Eficiencën e Energjisë së Kosovës. Të gjeturat e këtij monitorimi do të botohen veçantë, mirëpo në përgjithësi, INDEP ka konstatuar se ky ligj është duke u zbatuar vetëm pjesërisht. Disa nga gjetjet kryesore janë:

- Plani i Veprimit për Eficiencë të Energjisë nuk është në harmoni me Direktivat Evropiane. Si i tillë është në fuqi dhe është duke u implementuar në masë jo të kënaqshme.
- Ministria për Zhvillim Ekonomik ka ekzekutuar me sukses detyrat e parapara me Ligjin për Eficiencën e Energjisë.
- Si rezultat i themelimit me vonesë të AKEE-së janë përmbushur vetëm disa nga obligimet e parapara me kornizë ligjore.
- AKEE tashmë është funksionalizuar, edhe pse ka mungesë të stafit të plotë të punës.
- Mangësi tejet e madhe vlerësohet të jetë mungesa e zyrave komunale për energji, si përgjegjëse të vetme për hartimin e planeve komunale për eficiencë të energjisë në bashkëpunim me AKEE-në, bën që pjesët për eficiencë të energjisë nëpër komuna të mos jenë duke u implementuar fare.

INDEP ka vlerësuar edhe anët pozitive të Ligjit të Eficiencës së Energjisë. Vlerësime pozitive nga monitorimi i Ligjit të Eficiencës së Energjisë janë krijimi i Udhëzimit Administrativ për themelimin dhe funksionimin e Komisionit për Certifikimin e Auditorëve dhe Menaxherëve të Energjisë, qasja e hapur e AKEE-së ndaj palëve të jashtme të interesuara për financim e bashkëpunim dhe nxjerrja e Udhëzimit Administrativ për Auditimin e Energjisë.

Aktet tjera nënligjore që mungojnë e që janë të parapara me Ligjin e Eficiencës së Energjisë janë Aktet nënligjore për zbatimin e dispozitave të Direktivave të BE-së, aktet nënligjore për përgatitjen e planeve komunale për eficiencën e energjisë dhe aktet nënligjore për menaxhimin e energjisë në sektorin publik.

#### **4. ANALIZË KRAHASUESE E LIGJIT PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË SË KOSOVËS ME SHTETET E RAJONIT**

Me qëllim të vlerësimit të progresit që ka arritur Kosova sa i përket afrimit të legjislacionit dhe politikave të eficiencës me ato të BE-së, INDEP ka krahasuar legjislacionin e Kosovës me vendet e rajonit. Në analizën krahasimore janë përfshirë këto shtete: Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Kroacia, Turqia. Gjithashtu janë konsultuar edhe Direktiva e Bashkimit Evropian 2006/32 si dhe direktiva e re 2011/0172 për Eficiencën e Energjisë. Krahasimi me Direktivën 2011/0172 është bërë vetëm për të parë sfidat e reja me të cilat shtetet pritet të përballen kur kjo direktivë të hyjë në fuqi më 1 janar 2014. Kjo analizë do të paraqesë të gjeturat kryesore që kryesisht kanë të bëjnë me mungesat e Ligjit të Eficiencës së Kosovës në krahasim me ligjet e vendeve të lartpërmendura.<sup>32</sup> Duhet cekur se Ligji i Kosovës për Eficiencën e Energjisë është i mangët në shumë fusha pasi që një mori masash që do të përshkruhen më poshtë nuk janë të përcaktuara me ligj por me Planin e Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2010-2018. Në anën tjetër, shtetet e lartpërmendura listojnë më shumë masa direkt në Ligjet e Eficiencës së Energjisë. Kështu, një rëndësi e madhe i është kushtuar përmbajtjes së Planit të Veprimit në mënyrë që studimi të jetë sa më gjithëpërfshirës.

Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AKEE), si institucion implementues për Eficiencën e Energjisë, përveç Kosovës është e pranishme edhe në Shqipëri, Serbi dhe Rumani. Përderisa, në Kroaci ekziston Këshilli i Rregullatorit të Energjisë, në Bullgari Komisioni Shtetëror i Rregullimit të Energjisë ndërsa në Turqi Bordi Koordinues për Eficiencë të Energjisë.

Shtetet e rajonit dallojnë nga njëra-tjetra edhe në cakun e kursimit primar të energjisë. Direktiva 2006/32 e Bashkimit Evropian kërkon kursim të energjisë prej 9% ndërsa direktiva e re 2011/0172 do të parashikoj që deri më 2020 të kursethet 17% e konsumit primar të energjisë. Kjo shifër qëndron në 9% deri më 2018 për Kosovën<sup>33</sup>, 26% deri më 2020 për Shqipërinë<sup>34</sup>, 20% deri më 2023 për Turqinë<sup>35</sup>, 9% deri në 2016 për Malin e Zi<sup>36</sup>, 20% deri në 2020 për Kroacinë<sup>37</sup> dhe 2.8 Mtoe (përkatesisht 13.5%) deri në 2016 për Rumaninë<sup>38</sup>. Plani i Veprimit është hartuar në

---

<sup>32</sup> Aneks I shërben si përmbledhje e informatave të paraqitura në këtë pjesë.

<sup>33</sup> Plani i parë afat mesëm i Veprimit i Eficiencës së Energjisë për Kosovën (2010-2012) faqe 19

<sup>34</sup> Energy Charter Protocol on Energy Efficiency and Related Environmental Aspects PEEREA (2007), Albania, a regular review of Energy Efficiency policies report.

<sup>35</sup> ABB Group. National energy policies, and energy efficiency and CO<sub>2</sub> trends for industries and utilities. Country Report: Turkey. (2011). faqe 1.

<sup>36</sup> Ministria e Ekonomisë së Malit të Zi. Eficiencia e Energjisë në Malin e Zi – Plan Nacional i Eficiencës së Energjisë. (2010). (Anglisht)

<sup>37</sup> ABB Group. National energy policies, and energy efficiency and CO<sub>2</sub> trends for industries and utilities. Country Report: Croatia. (2011).

<sup>38</sup> ABB Group. National energy policies, and energy efficiency and CO<sub>2</sub> trends for industries and utilities. Country Report: Romania. (2011).

shtator 2011 dhe ka synuar të jetë në harmoni me kërkesat e Direktivës Evropiane 2006/32. Direktiva kërkon në mënyrë të qartë që objektivi prej 9% të arrihet në nëntë vitet e zbatimit të Direktivës, rrjedhimisht deri më 2016. Ministria e Zhvillimit Ekonomik insiston që objektivat e Kosovës janë në përputhje me Direktivën 2006/32 të BE-së.<sup>39</sup> Megjithatë, plani i Veprimit i Kosovës, parasheh objektivin prej 9%, por ky objektivi do të arrihet tek më 2018, çka e bën Planin e Veprimit të mos jetë në harmoni me kërkesat e BE-së. Direktiva 2006/32 e ndan periudhën e vlerësimit të progresit në tri pjesë: 2008, 2012 dhe 2015<sup>40</sup>, kurse Plani i Veprimit i Kosovës mbi Eficiencën e Energjisë gjithashtu nxjerr tri plane afatmesme dhe raporton progresin në vitet 2012, 2015 dhe 2018<sup>41</sup>, që do të thotë që është 2 deri në 3 vite prapa direktivës. Ndërkohë, shtetet e BE-së zakonisht e caktojnë cakun më të lartë se sa direktiva e BE-së në mënyrë që të stimulojnë arritjen e caktuar të paraparë me direktivë.<sup>42</sup> Të gjitha këto demonstrojnë edhe një herë se Plani i Veprimit dhe Direktiva 2006/32 e BE-së nuk janë në përputhje me njëra tjetrën.

Auditimi i sistemeve të ngrohjes, që do të kërkohet në Direktivën 2011/0172 të Bashkimit Evropian për Eficiencën e Energjisë, është një tjetër mekanizëm i rëndësishëm për të kursyer energjinë. Ky mekanizëm është i përfshirë vetëm në Ligjin për Eficiencën e Energjisë së Malit të Zi ndërsa mungon në të gjitha vendet e tjera të rajonit të krahësuar në këtë studim duke përfshirë edhe Kosovën. Miratimi i aktit nënligjor për auditimin e energjisë, siç parashihet në Ligjin për Eficiencën e Energjisë së Kosovës, është kryer me sukses. Megjithatë, në ligj nuk specifikohet që me këtë akt të rregullohet auditimi i sistemeve të ngrohjes që do të ishte i domosdoshëm për uljen e nivelit të konsumit të energjisë.

Në mënyrë që konsumatorët e fundit të jenë të informuar në lidhje me rëndësinë e të kursyerit të energjisë, masat e vetëdijesimit duhet të jenë në shërbim të qytetarëve. Në ligjet e Malit të Zi, Serbisë, Kroacisë, Rumanisë dhe Turqisë përmendet edukimi si një komponentë për promovimin e përdorimit eficient të energjisë, përderisa në ligjet e Kosovës, Shqipërisë dhe Bullgarisë nuk përmendet një gjë e tillë. Plani i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2010-2018 përmban disa masa për promovimin e eficiencës, ndër të cilat edhe një projekt për ndriçimin eficient të rrugëve

---

<sup>39</sup> Intervistë e INDEP me Luan Morinën, Drejtor i Departamentit të Energjisë dhe Minierave në MZHE. Prishtinë, Kosovë, Shtator 2012.

<sup>40</sup> Direktiva 2006/32/EC, Neni 14.

<sup>41</sup> Intervistë e INDEP me Bedri Dragushën, Kryeshf i Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Prishtinë, Kosovë, Korrik 2012.

<sup>42</sup> Intervistë e INDEP me Vlasia Oikonomou, Ekspert (Politikat e Energjisë dhe Klimës) në Joint Implementation Network. Prishtinë, Kosovë, Tetor 2012



publike, projekt ky i përfunduar në vitin 2011.<sup>43</sup> Vlen të ceket rasti i Turqisë ku çdo televizion dhe radio, me mbulueshmëri kombëtare apo lokale, obligohet që të transmetoj të paktën 30 minuta në muaj spote të vetëdijesimit për eficiencën e energjisë.<sup>44</sup> Në Kosovë janë ndërmarrë fushata për promovimin e eficiencës nga institucione të ndryshme, mirëpo këto fushata nuk parashihen me ligj që do të thotë se nuk kemi detyrime dhe nuk ka garanci që fushatat do të organizohen edhe në të ardhmen. Një praktikë e tillë do të ndihmonte konsiderueshëm në vetëdijësimin e popullatës, dhe në rastin e Kosovës reklamimi në Radio Televizionin e Kosovës (RTK) do të ishte i mjaftueshëm si hap fillestar.

Sanksionet për ata që nuk iu nënshtrohen rregullave të parapara me ligj janë evidente në Ligjet për Eficiencën e Energjisë në shtete të ndryshme. Nga ato të zgjedhura për këtë analizë, vetëm Kosova dhe Kroacia nuk kanë gjopa sanksionuese, përderisa vendet tjera parashohin një gjobë të tillë. Gjobën më të lartë e ka Rumania e cila mund të arrijë deri në 330,000€<sup>45</sup> dhe më të voglën Shqipëria me 730€.<sup>46</sup> Variacioni në sasinë e dënimeve është specifik për secilin shtet dhe në Kosovë dënime të tilla, nëse vendosen, duhet të bëhen në bazë të studimit të dëmeve të shkaktuara nga shkelja e ligjit.

Direktiva 2011/0172 e Bashkimit Evropian cekë që fatura e pagesës së energjisë elektrike duhet të përmbajë informata rreth eficiencës së energjisë. Këto informata do të përfshinin konsumin e energjisë për të njëjtën periudhë në vitin paraprak, çmimin e energjisë për të njëjtat periudha dhe konsumin e energjisë së konsumatorit në krahasim me mesataren e konsumit të konsumatorëve të të njëjtit grup. Kjo është e cekur vetëm në Ligjin për Eficiencën e Energjisë së Malit të Zi, ndërsa mungon në shtatë vendet tjera të analizuara në këtë punim duke e përfshirë edhe Kosovën.

Një komponentë tjetër që hyn në direktivën e BE-së, e që shumica e shteteve të rajonit nuk e plotësojnë, janë matësit inteligjent të rrymës. Serbia dhe Rumania janë vendet të cilat kanë bërë progres në këtë fushë. Kosova gjithashtu ka shënuar përparime në këtë aspekt pasi që tashmë ekziston një pilot projekt për instalimin e matësve inteligjent të rrymës i cili ka filluar

---

<sup>43</sup> Ministria e Zhvillimit Ekonomik: Promovimi i ndriçimit eficient – Projekti “Zbatimi i masave të eficiencës në institucionet publike në kuadër të realizimit të planit kombëtar të EE sipas kërkesave të BE-së dhe TKE-së zbatimi i vendimit të Qeverisë për poqa kursyes - ndriçimi i rrugëve publike”.

<sup>44</sup> Ligji No.5627 i Eficiencës së Energjisë. Turqi. Neni 6.

<sup>45</sup> Ligji No. 199/2000 për Përdorimin Eficient të Energjisë. Rumania. Neni 25.

<sup>46</sup> Ligji Nr. 9379 për Eficiencën e Energjisë. Republika e Shqipërisë. Neni 13.

implementimin në 2012, sipas planifikimit të KEK.<sup>47</sup> Projekti tanimë është implementuar në një pjesë të Prishtinës.

Në katër nga tetë shtetet e mbuluara në këtë analizë hasim në detyrime për prodhuesit dhe importuesit e produkteve që konsumojnë energji. Në Kosovë, në Planin e Parë Afat Mesëm të Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2010-2012, ekzistojnë instruksione administrative për etiketimin e pajisjeve elektrike shtëpiake, fushë e cila bëhet edhe më e plotësuar kur konsiderohet Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2012 për Etiketimin e Pajisjeve që Shfrytëzojnë Energji.<sup>48</sup> Në Shqipëri, në detyrohet etiketimi i pajisjeve elektrike shtëpiake për prodhuesit dhe importuesit e tyre në gjuhën shqipe, ku në mes tjerash duhet të ketë informata rreth eficiencës së energjisë për produktin.<sup>49</sup> Në Mal të Zi parashihet që produktet futen në treg vetëm nëse i përmbushin kërkesat eko-eficiente të parapara nga Ministria e linjës, kurse etiketimi i produktit duhet të përfshijë informata rreth eficiencës së energjisë.<sup>50</sup> Kroacia obligon prodhuesit që të përshkruajnë në etiketim llojin e energjisë apo lëndës djegëse dhe eficiencën e energjisë së atij produkti.<sup>51</sup> Të gjitha këto provizione sigurojnë që prodhuesit dhe përdoruesit fundor të paktën të jenë të vetëdijshëm rreth sasisë së energjisë që konsumojnë, duke rritur mundësinë që këta persona të marrin masa vetanake për rritjen e eficiencës.

Kompanitë të cilat e kalojnë një shifër të konsumit vjetor të energjisë të caktuar me rregullore quhen konsumuesit e mëdhenj të energjisë. Konsumuesit e mëdhenj të energjisë është term i cili përdoret në ligjin e Malit të Zi dhe atë të Rumanisë. Ligjit për Eficiencën e Energjisë së Malit të Zi i obligon konsumuesit e mëdhenj të energjisë të zhvillojnë plane vjetore për përmirësimin e eficiencës, si dhe raporte të zbatimit të atij plani.<sup>52</sup> Po i njëjti ligj obligon konsumuesit e mëdhenj të energjisë të krijojnë sisteme të informimit për monitorimin e konsumit të energjisë dhe t'i dorëzojnë raportet vjetore në ministrinë përkatëse, duke specifikuar totalin e energjisë së konsumuar për produkt të gjeneruar, sasinë e energjisë së konsumuar për secilën ndërtesë, sipërfaqen e shfrytëzueshme të ndërtesës, numrin e punonjësve, etj.<sup>53</sup> Në anën tjetër, edhe Ligji i Rumanisë i përmban disa detyrime për konsumuesit e mëdhenj të energjisë, ku thuhet që këto të fundit duhet të krijojnë programet e tyre afatshkurta dhe afatgjate të eficiencës së energjisë.<sup>54</sup> Kosova nuk ka paraparë një kategori të tillë të veçantë të konsumatorëve për të cilët do të kishte

---

<sup>47</sup> Gjukaj, A., Bualoti, R. Application of Smart Grid in Kosovo Power System. *Perspectives of Innovations, Economics & Business* (2011) Volume 8 / 2 : 57-62.

<sup>48</sup> Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Plani i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2010-2018. Kosovë (2011). Faqe 29.

<sup>49</sup> Ligji Nr. 9379 për Eficiencën e Energjisë, Republika e Shqipërisë, Neni 5.

<sup>50</sup> Ligji No. 29/2010 për Eficiencën e Energjisë. Mal i Zi. Neni 36 dhe 38..

<sup>51</sup> Akti Nr. 68/01 i Energjisë, Republika e Kroacisë. Neni 13.

<sup>52</sup> Ligji No. 29/2010 për Eficiencën e Energjisë. Mal i Zi. Neni 20.

<sup>53</sup> Ligji No. 29/2010 për Eficiencën e Energjisë. Mal i Zi. Neni 41 dhe 42.

<sup>54</sup> Ligji No. 199/2000 për Përdorimin Eficient të Energjisë. Rumania. Neni 5.

obligime shtesë apo masa stimuluese që këta konsumues të instalojnë sisteme eficiente të konsumit të energjisë.

Një tjetër komponentë e promovimit të përdorimit eficient të energjisë janë masat stimuluese, që mund të jenë në formë të subvencioneve apo formave tjera. Analiza tregon që katër nga tetë shtetet e krahasuara përdorin masa stimuluese, e ato janë: Mali i Zi, Kroacia, Rumania dhe Turqia. Njëra nga masat më të shpeshta të përdorura është lirimi nga taksat ose ofrimi i çmimeve të favorshme nga shpërndarësi i energjisë për përdoruesit eficient. Në Rumani parashihet krijimi i një fondi të veçantë për arritjen e objektivave të eficiencës së energjisë, ku konsumatorët e energjisë mund të përfitojnë financime për projekte lidhur me eficiencën. Për më tepër, Rumania gjithashtu stimulon kompanitë eficiente duke ju ofruar kredi me interes të favorshëm dhe lirim nga taksa në profit dhe taksa doganore.<sup>55</sup> Turqia, në anën tjetër, jep mbështetje financiare për projektet që e promovojnë përdorimin eficient të energjisë dhe ofron: trajnime, konsultime dhe auditime falas për firmat e vogla dhe të mesme, si dhe certifikatat e autorizimit dhe ato për menaxher të energjisë jepen falas.<sup>56</sup> Tek Kosova, edhe pse nuk specifikohet në ligj, aplikohen masa stimuluese për konsumatorët që e kursejnë energjinë, ani pse në formë shumë bazike. Çdo faturë e KEK-ut i shpjegon kategoritë e ndryshme të tarifave, ku sa më i madh është konsumi i energjisë aq më e madhe është tarifa e aplikuar. Problemi në këtë rast qëndron te pamundësia e targetimit të bizneseve apo amvisërisë, prandaj kjo politik dhe shumica e politikave të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë kanë aspekt gjithëpërfshirës.<sup>57</sup> Plani i Parë Afat-Mesëm i Veprimit 2010-2012 i Kosovës thekson që 10 milion euro janë të gatshme për t'u shpërndarë si kredi për individë dhe biznese të vogla dhe të mesme në mënyrë që të financohen projekte që kanë të bëjnë me eficiencën e energjisë.<sup>58</sup> Një shumë e tillë është e pamjaftueshme për të konsideruar se është bërë mjaftueshëm për të stimuluar investimet në drejtim të instalimit të sistemeve eficiente të energjisë.

Masat stimuluese të aplikuara në shtetet e analizuar				
Masa	Lirimi nga taksat	Financimi i projekteve për eficiencën	Kredi me interes të favorshëm	Tarifa të favorshme për përdoruesit eficient
Shteti	Mal të Zi, Rumani	Rumani, Turqi	Rumani	Mal të Zi, Kroaci

<sup>55</sup> Ligji No. 199/2000 për Përdorimin Eficient të Energjisë. Rumani. Neni 22.

<sup>56</sup> Ligji No. 5627 i Eficiencës së Energjisë. Turqi. Neni 8 dhe 9. .

<sup>57</sup> Intervistë e INDEP me Ardian Berishën, Kryesues i Departamentit për Tarifa dhe Çmime në ZRRE. Prishtinë, Kosovë, Shtator, 2012

<sup>58</sup> Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Plani i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2010-2018. Kosovë (2011). Faqe 38.

Detyrimet për secilin objekt ndërtimor hasen në Malin të Zi ku thuhet se çdo ndërtesë e re apo që i nënshtrohet një renovimi të madh duhet të jetë e dizajnuar që të shpenzojë sasi të caktuar të energjisë.<sup>59</sup> Në Turqi çdo ndërtesë që ka mbi 20,000m<sup>2</sup> apo konsum me mbi 500 TOEs (ton naftë ekuivalent) duhet të ketë një menaxher të energjisë, ndërsa kompanitë private me mbi 50000 TOEs konsum vjetor duhet të kenë një njësi të veçantë që do të merrej me menaxhimin e efijencës së energjisë.<sup>60</sup> Edhe Kosova liston masa për rregullat teknike për performancën e energjisë së ndërtesave.<sup>61</sup> Sidoqoftë, implementimi i këtyre kërkesave nuk ekziston.

Për dallim nga detyrat e Agjencisë së Kosovës për Efijencën e Energjisë agjencia e Rumanisë merret me akreditimin e institucioneve që bëjnë teste dhe matje për efijencën e pajisjeve teknike, si dhe ka kompetencën që të krijojë standarde për këto matje.<sup>62</sup> Në Turqi, Bordi Koordinues për Efijencë të Energjisë, i cili është rregullatori i efijencës së energjisë në vend bën studime për efijencën, monitoron rezultatet dhe zbaton ato, bën çertifikime, aprovon projekte të sektorit privat, dhe organizon takime të komiteteve këshilluese.<sup>63</sup> Politika të tilla si akreditimi i institucioneve që bëjnë teste dhe matje për efijencën e energjisë, financimi i projekteve të sektorit privat dhe investimet në fushën e studimeve në fushën e efijencës do të ishin tejet të nevojshme dhe do të sillnin rezultate në planin afatgjatë.

Të gjetura të tjera që vlen të cekën janë në ligjet e Shqipërisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Rumanisë. Shqipëria përcakton burimet financiare për realizimin e programit kombëtar të efijencës së energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Energjisë është organi kompetent për administrimin e fondit për Efijencën e Energjisë.<sup>64</sup> Mali i Zi ka ligjin më të kompletuar për efijencën e energjisë, ku ndër të tjerash theksohet se qeveritë lokale detyrohen të dorëzojnë një Program për Përmirësimin e Efijencës tek Ministria, planet komunale duhen të jenë të ndërlidhura me strategjinë/planin kombëtar për efijencën, komunat detyrohen që të bëjnë fushata vetëdijesimi për efijencën dhe me rastin e shitjes së një objekti ose të lëshimit me qera, pronari duhet t'ia dorëzojë blerësit një certifikatë të performancës së energjisë së atij objekti.<sup>65</sup> Në anën tjetër, Bullgaria i obligon kompanitë të cilat merren me ekstraktimin, përpunimin dhe shpërndarjen e energjisë që të bëjnë studime dhe analiza me parashikime për ekstraktimin dhe procedimin e burimeve të energjisë. Gjithashtu, një herë në dy vjet duhet të dërgojnë raporte tek

---

<sup>59</sup> Ligji No. 29/2010 për Efijencën e Energjisë. Mal i Zi. Neni 21.

<sup>60</sup> Ligji No. 5627 i Efijencës së Energjisë. Turqi. Neni 7.

<sup>61</sup> Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Plan i Veprimt për Efijencën e Energjisë 2010-2018. Kosovë (2011). Faqe 36.

<sup>62</sup> Ligji No. 199/2000 për Përdorimin Eficient të Energjisë. Rumania. Neni 13.

<sup>63</sup> Ligji No. 5627 i Efijencës së Energjisë. Turqi faqe 3

<sup>64</sup> Ligji Nr. 9379 për Efijencën e Energjisë, Republika e Shqipërisë, Neni 10 dhe 11.

<sup>65</sup> Ligji No. 29/2010 për Efijencën e Energjisë. Mal i Zi. Neni 8, 10, 14 dhe 27.

ministra për masat e përmirësimit të efikasitetit të energjisë.<sup>66</sup> Ndërkohë ajo çka Ligji i Rumanisë përmban për dallim nga vendet e tjera është shpjegimi i principeve dhe objektivave të Strategjisë Kombëtare të Energjisë. Kërkesa të tilla si fondi për efikasitet dhe bërja e studimeve në fushën e efikasitetit të energjisë, mungojnë në kornizën legjislative të Kosovës ndërsa planet komunale për efikasitet nuk janë hartuar asnjëherë dhe nuk ka filluar të implementohen.

## 5. PËRFUNDIMET

Korniza ligjore e Kosovës në fushën e efikasitetit të energjisë është i mangët dhe në shumë raste e pazbatueshme në praktikë. Ligji parashih që shumica e masave, detyrimeve dhe objektivave të rregullohen me akte nënligjore dhe jo direkt me ligj. Në formën e tanishme, ligji ka rregulluar në mënyrë të qartë krijimin e Agjencisë së Kosovës për Efikasitet të Energjisë, por nuk ka rregulluar shumë prej masave dhe detyrave që duhet të ndërmerren në drejtim të arritjes së nivelit të pritur të efikasitetit. Një pjesë e akteve nënligjore ende nuk janë formuar, që si rrjedhojë kanë bërë që kompletimi i bazës ligjore të mbetet një sfidë e papërfunduar tërësisht.

Themelimi i Agjencisë Kosovare për Efikasitet të Energjisë ka qenë hap pozitiv. Sidoqoftë, Agjencia është themeluar me vonesë dhe si rezultat ka arritur të përmbushë vetëm disa nga detyrimet e saj. Për më tepër Agjencia nuk ka pasur një linjë të veçantë buxhetore të paraparë me Buxhetin e Kosovës për vitin 2012 dhe as me rishikimin e Buxhetit që është bërë në qershor 2012. Buxhet është ndarë vetëm për Energjinë si sektor në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe nuk është paraparë buxhet i veçantë për AKEE-në.<sup>67</sup> Agjencia ka adresuar kërkesat e dala nga Plani kombëtar për Efikasitet të Energjisë dhe është duke implementuar planin afatmesëm 2010–2012. Agjencia gjithashtu është në fazën e parë të hartimit të planit afatmesëm 2013–2015 dhe është duke monitoruar me sukses planin e parë afatmesëm. Sfidë për Agjencinë mbetet mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për implementimin e detyrave të saj. Stafi i Agjencisë ende nuk është kompletuar dhe gjithashtu mungon hapësira e nevojshme për punë. Agjencia si një institucion i pavarur i mungon gjithashtu një ueb faqe në të cilën do të publikohej baza ligjore, raporte vjetore si dhe të dhëna të tjera që do të ishin të dobishme për donator dhe investitor potencial në këtë fushë.

Në nivelin komunal nuk është bërë asgjë në fushën e efikasitetit të energjisë. Mungesa e zyrave komunale të energjisë ka bërë që të mos ketë plane komunale që do të ndihmonin implementimin e planit nacional të efikasitetit. Ligji për Efikasitetin e Energjisë ka dështuar të

---

<sup>66</sup> Ligji Nr. 107/2003 për Energji. Republika e Bullgarisë, Neni 4.

<sup>67</sup> Ligji Nr. 04/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

sqarojë krijimin e këtyre zyrave, për faktin se krijimi i tyre mbetet kompetencë e nivelit komunal si një autoritet politikisht jo i pavarur. Gjithashtu nuk është bërë kompletimi i bazës ligjore në këtë drejtim pasi që mungon udhëzimi administrativ për përgatitjen e planeve komunale të eficiencës së energjisë.

Auditimi i sistemeve të ngrohjes dhe të klimatizimeve ka dështuar të bëhet dhe legjislacioni i Kosovës nuk ka paraparë që kjo gjë të jetë e obliguar. Udhëzimi administrativ për auditimin e energjisë është hartuar ashtu siç kërkonte Ligji për Eficiencën dhe Direktiva Evropiane 2006/32.

Kosova nuk ka paraparë gjopa për shkelësit e detyrimeve ligjore. As me Ligjin për Eficiencë dhe as me Planin për Eficiencë, nuk parashihen gjobat për shkelje ligjore dhe për shpërfillje të objektivave të eficiencës së energjisë. Shumica e shteteve të analizuara (gjastë nga tetë) kanë paraparë gjopa dhe provizionet ndëshkuese kanë qenë të parapara edhe me Direktivat e BE-së. Në këtë pikë Kosova ka dështuar të përmbushë këtë kërkesë të Direktivave të BE-së dhe përbën një përjashtim edhe nga praktika e vendeve në rajon. Në ligjin e eficiencës së energjisë, gjobat do të mund të përdroreshin si një instrument i mirë për të detyruar implementimin e dispozitave të Planit të Veprimit dhe Planeve afatmesme dhe atyre komunale në fushën e eficiencës. Detyrimi me gjopa do të stimulonte Konsumuesit e Mëdhenj të Energjisë të hartonin projekte të eficiencës së energjisë dhe do ishte stimulim që objektet të instalojnë sisteme eficiente të konsumit të energjisë.

Caku i eficiencës së energjisë prej 9% deri më 2018 ka qenë i ulët dhe nuk ka përmbushur kërkesat e Direktivës Evropiane 2006/32 që caku prej 9% të arrihej deri më 2016. Për më tepër, niveli i kalkuluar i konsumit mesatar të energjisë, prej nga është nxjerrë sasia e energjisë që duhet kursyer, nuk ka qenë në përputhje me të dhënat e Strategjisë së Energjisë 2009-2018, çka ka ulur nivelin e eficiencës së energjisë. Caku prej 9% me direktivën e re të BE-së 2011/0172, do të jetë tërësisht jo relevant. Direktiva e re e Bashkimit Evropian që pritet të hyjë në fuqi më 1 janar 2014, do të kërkojë që shtetet deri më 2020 të mbërrijnë cakun e eficiencës së energjisë në së paku 17%. Rrjedhimisht, objektivat e tanishme të Kosovës për eficiencë nuk do të jenë në harmoni me kërkesat e reja të BE-së. Për më tepër, edhe në rast të arritjes së caktit të saj, Kosova përsëri do të ngelë prapa në krahasim me shtetet e rajonit e akoma më larg shteteve të BE-së.

Çmimi i energjisë në Kosovë është rritur për 8.9% prej muajit qershor të vitit 2012. Nuk ka të dhëna nëse një nivel i tillë i çmimeve ka ndikuar në rritjen e eficiencës së energjisë. Zyra e Rregullatorit të Energjisë në arsyetimin për vendimin e saj për shtrenjtimin e energjisë nuk ka

përmendur eficiencën e energjisë. Kur kësaj i shtohet edhe mungesa e mekanizmave për matjen e ndikimit të shtrenjtimit të rrymës në eficiencë, rezultati i kësaj politike mbetet i paditur.

Një masë e ndërmarrë që mund të cilësohet si zhvillim pozitiv është miratimi i ndryshimeve në Ligjin nr. 03/L-220 me të cilat secilit poq elektrik jo eficient do t'i vihet akcizë prej 30 centësh. Ky mbetet një hap mjaft i rëndësishëm pasi pritet të rrisë kërkesën për poqa eficient, çka do t'i kontribuonte eficiencës së energjisë. Miratimi dhe hyrja në fuqi i Udhëzimit Administrativ 09/2012 për Etiketimin e Pajisjeve Elektrike është një hap pozitiv në kompletimin e bazës ligjore në këtë fushë dhe në drejtim të informimit më të madh të konsumatorëve në lidhje me sasinë e energjisë që konsumohet. Megjithatë, një politikë e këtillë e 'shkopit' do duhej shoqëruar me politikën tjetër të 'karrotës' që në rastin më të mirë do të ishte stimulimi dhe subvencionimi i poqave eficientë, sidomos kur dihet situata e përgjithshme socio-ekonomike në Kosovë.

Në fushën e edukimit dhe informimit në Kosovë nuk është bërë mjaft. As Ligji për Eficiencë e as Plani i Veprimit nuk kanë paraparë reklama vetëdijësuese me karakter periodik, siç ishte shembulli i Turqisë. Ministria e Energjisë dhe ajo e Arsimit nuk kanë hartuar ndonjë projekt të përbashkët në fushën e arsimimit dhe edukimit në fushën e eficiencës. Fushata të ndryshme për eficiencën janë organizuar, mirëpo mungesa e tyre në ligj dështon të garantoj karakter periodik. Edhe në pjesën e informimit, rrjeti i distribucionit i KEK-ut ka dështuar të zbatojë obligimet e dala nga Direktivat e BE-së. Në faturat e konsumatorëve të energjisë nuk figurojnë informatat e duhura në lidhje me pasqyrën e konsumit përkatës, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

Kosova nuk ka paraparë masa të mjaftueshme stimuluese për promovimin e eficiencës së energjisë. Hapa pozitiv janë kreditë me kamata të ulëta që plani i veprimit ka paraparë të jepen për individë me projekte të eficiencës së energjisë dhe tarifatat e favorshme për përdoruesit eficient të energjisë. Megjithatë, ndër masat stimuluese që nuk janë paraparë janë lirimi nga taksat, zhvillimi i fondeve speciale për arritjen e objektivave të eficiencës për financimeve të projekteve, ose dhënien e kredive me interes të favorshëm për kompanitë eficiente.

## 6. REKOMANDIMET

Bazuar në gjetjet e bëra në analizën e mësipërme, INDEP ka nisur përpilimin e një dokumenti gjithëpërfshirës që do të mund të shërbente si bazë për zhvillimin e politikës së eficiencës së energjisë në Kosovë. Ndërsa, në këtë fazë, rekomandojmë që të ndërmerren këto masa në mënyrë që gjendja në fushën e eficiencës së energjisë të përmirësohet:

Kuvendi i Kosovës duhet të bëjë amandamentimin e Ligjit për Eficiencën e Energjisë. Një ligj i kompletuar i Eficiencës do të qartësonte krijimin e zyrave komunale, të përfshijë masa konkrete për rritjen e eficiencës që janë të cekura në planin e veprimit, të kërkojë auditimin e sistemeve të ngrohjes e klimatizimit, të obligoj aplikimin e fushatave për promovimin e përdorimit eficient të energjisë dhe të lë hapësirë për zhvillimin e akteve nënligjore të cilat duhet të përmbajnë detajet e zbatimit të politikës së përgjithshme të eficiencës.

Në ligjin e amandamentuar duhet të ofrohen masa stimuluese për përdoruesit eficient të energjisë si dhe të specifikohen afatet kohore të implementimit të tij. Sektorit privat duhet të i jepet rëndësi e veçantë duke i definuar kompanitë e mëdha që janë konsumues të mëdhenj të energjisë dhe t'ju ofrohet lirim nga taksat dhe çmime më të favorshme të energjisë. Gjithashtu ligji duhet të specifikojë gjoba për shkeljet e dispozitave, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i ligjit. Nga shembulli i Turqisë, rekomandohet të jepet mbështetje financiare për projektet që e promovojnë përdorimin eficient të energjisë. Për më tepër, definimi i afateve kohore për krijimin e zyrave komunale, hartimit të planeve komunale dhe funksionalizimit të sistemit të auditimit do të ishte i domosdoshëm në një ligj të amandamentuar.

Agjencia e Kosovës për Eficiencën e Energjisë duhet të përparojë procesin e krijimit të zyrave për energji nëpër komuna. Ky do të ishte hapi i fundit në kompletimin e kuadrit institucional për eficiencën e energjisë. Një hap i tillë do t'i hapte rrugë hartimit dhe implementimit të planeve komunale që do të ndihmonin implementimin e Planit Nacional të Eficiencës.

AKEE në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit duhet të ndërmarrin fushata vetëdijësuese me karakter afatgjatë në mënyrë që të shtohen aktivitetet në fushën e edukimit dhe vetëdijesimit. Veç kësaj, AKEE duhet të përgatisë fushata vetëdijësuese mbi rëndësinë e eficiencës së energjisë.

Plani i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2010-2018, ku është vënë objektiva që deri më 2018 të kursehet 9%, duhet të ndryshohet nga Ministria për Zhvillim Ekonomik. Së pari, një plan i



përmirësuar i veprimit do të e bënte parashikimin e sasisë së energjisë për t'u kursyer duke u bazuar në 5 vitet e fundit të konsumit, kështu që përqindja e nxjerrë do të ishte pasqyrë reale e gjendjes. Duke mos qenë i njëtrajtshëm me Direktivën 2006/32 të BE-së, ky plan duhet të përgatitet që të pasqyrojë kërkesat e Direktivës së re Evropiane 2011/0172 mbi obligimet e reja për energji, ku objektiva është 17% deri më 2020. MZHE po ashtu duhet të hartojë strategji të veçanta afatmesme për zbatimin e këtij plani. Gjithashtu, edhe niveli komunal me anë të planeve komunale duhet të pasqyrojnë këto caqe të reja.

ZRRE dhe MZHE rekomandohen që të krijojnë mekanizma që bëjnë matje të përpiktë të elasticitetit në rastin e rritjes së tarifave. Duke e matur potencialin për të kursyer energji, elasticitetit do të ndihmonte vënien e politikave më të mençura për eficiencën.

7. ANEKSET. Aneksi I: Tabela Krahasuese

	Kosova	Shqipëria	Mali i Zi	Serbia	Kroacia	Bullgaria	Rumania	Turqia	EU - Direktiva
<b>Regullatori</b>	Agjencia	Agjencia	Ministria	Agjencia	Keshilli i rregullatorit të energjise	Komisioni shtetëror i rregullimit të energjise	Agjencia	Bordi Koordinues për Eficiencë të Energjisë	Shtetet anëtare
<b>Plane</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	
<b>Objektivi për Eficiencë</b>	9% deri në 2018	26% deri në 2020	9% deri në 2016	/	20% deri në 2020	Pa specifikuar	13.5% deri në 2016	20% deri në 2023	17% deri në 2020
<b>Niveli Komunal</b>	Zyrat komunale	Njësitë qarqeve	Njësitë e veteqeverisjes lokale	Njësitë e veteqeverisjes lokale	Komunat	Njësitë e veteqeverisjes lokalet	Njësitë lokale të Ministrise	Asociacioni i Komunave	
<b>Spektori privat</b>	<b>E rregulluar Plan të Veprimit</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>
<b>Auditimi</b>	Me akt nënligjor	Në ligj	Në ligj	Me akt nënligjor	Me akt nënligjor	Në ligj	Me akt nënligjor	Në ligj	Direktiva
<b>Auditimi i sistemeve të ngrohjes dhe klimatizimit</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>
<b>Autoriteti që e bënë licencimin e auditoreve</b>	Këshilli	Ministri	Ministria	/	/	Ministri	/	Ministria	/
<b>Subvencionet</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>/</b>
<b>Edukimi/Informimi</b>	<b>E rregulluar Plan të Veprimit</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>
<b>Gjobat - maksimalja</b>	<b>X</b>	730 €	300 x paga minimale	25,000 €	<b>X</b>	75,000 €	330,000 €	22,600 €	<b>✓</b>
<b>Informatat në fature</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>
<b>Matësit inteligjent të rrymës</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>
<b>Detyrimet e prodhuesve dhe importuesve të produkteve që konsumojnë energji</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>
<b>Detyrimet e 'Big Energy Consumers'</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>X</b>
<b>Masat Stimuluese</b>	<b>E rregulluar Plan të Veprimit</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>
<b>Detyrimet për objektet që shpenzojnë energji</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>✓</b>	<b>X</b>

ISBN 978-9951-627-03-0



9 789951 627030

INDEP 2012